



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e IV-të (katër - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 14 tetor 2022

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10:07.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: z.Haki Rudari, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa dhe z.Naile Ahmeti, ndërsa munguan, znj.Qëndresë Hajrizi, z.Demokrat Hodolli dhe z.Selver Rama

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Xhevrie Beqiri nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim-Podujevë, përfaqësuesi nga Stacioni i Policisë në Podujevë z.Fadil Babatinca, përfaqësuesi i OSBE z.Bekim Karaxhija.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, theksoi, rendin dhe materialin përkatës për këtë mbledhje e keni marrë me kohë dhe keni pas kohë të mjaftueshme besoj që ta shqyrtoni dhe analizoni, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

z.Haki Rudari, theksoi, e kemi marrë materialin për këtë seancë mirëpo sa po shoh këtu prezent nuk e kemi ndonjë nga zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, e them këtë sepse e kemi pikën e 2-të të rendit të ditës, andaj mendoj se është një lloj jo realitet apo një lloj shprazëtie që ne të diskutojmë për diçka që nuk kemi material dhe as përfaqësues të Drejtorisë përkatëse, ashtu siç kemi situatën e njëjtë edhe për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Prandaj në këtë situatë ku nuk kemi kurrfarë material apo informate nga këto dy Drejtori.

Në fakt në mbledhjen e kaluar e kemi heq nga rendi i ditë informatën e DKA-së për shkak se nuk është sjellë informata me shkrim, edhe pse ka qenë një zyrtar nga ajo Drejtori i cili ka diskutuar në kuptimin teorik, mirëpo ne kemi kërkuar që të kemi material me shkrim mbi bazë të të cilës pastaj mund të diskutojmë. Tani sërish në këtë mbledhje nuk kemi material dhe madje as nuk e kemi prezent ndonjë zyrtar nga Drejtoria e Arsimit e as nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Unë po shpresoj se Zyra përkatëse e ka dërguar thirrjen e kësaj mbledhje edhe tek Drejtoritë përkatëse, andaj do të ishte mirë të informohemi përse ka ndodh kështu.

Zyrtari nga Zyra Ligjore, duke i'u përgjigjur parafolësit thekson se materiali i'u dërgohet vetëm anëtarëve të Komitetit dhe atyre akterëve tjerë që duhet të marrin pjesë në mbledhje, ndërsa Kryesuesi i Komitetit së bashku me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim i bëjnë organizimet tjera

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, lidhur me çështjen në fjalë ju informoj se unë personalisht kam qenë në dy Drejtoritë përkatëse dhe ju kam lënë nga një thirrje të kësaj mbledhje dhe njëkohësisht ju kam kërkuar që të jenë pjesëmarrës në këtë mbledhje si dhe ta sjellin materialin e kërkuar, ndërsa përse nuk kanë ardhë në mbledhje nuk kam kurrfarë informate.

znj.Xhevdie Beqiri, zyrtare në Zyrën Komonale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, theksoi, sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës që ka të bëjë me infrastrukturën në kuadër të drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, ju informoj se meqë nuk është ndokush prezent nga kjo Drejtori atëherë unë mund të prezantoj projektet e kësaj Drejtorie që kanë të bëjnë direkt me Komitetin jo shumicë për të cilat kjo Drejtori na ka informuar edhe neve si ZKKK.

Pra ne si ZKKK në bashkëpunim me DSHPMSH i kemi përgatitur këto projekte dhe të njëjtat i kemi dërguar në Zyrën për çështje të Komuniteteve, e që më vonë mundemi ta elaborojmë më gjerësisht

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësen dhe mirëpres informatën nga ajo lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës. Tani nuk kemi material e as zyrtar të DKA-së lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës.

z.Haki Rudari, theksoi, unë e dëgjova arsyetimin nga parafolësja zyrtare e ZKKK-së dhe mendoj se janë dy çështje krejt të kundërta sepse ZKKK është diçka e veçantë si dhe DSHPMSH është diçka tjetër, do të thotë i kanë kompetencat dhe detyrat e ndara.

Sërish e përsërisë se për pikat 2 dhe 3 nuk kemi material mbi bazën e të cilave do të mund të diskutonim, andaj kjo është ajo vërejtja ime të cilën është dashtë ta marrin për bazë këto dy Drejtori, për arsye se në pikën 2 të rendit të ditës kemi Informatë nga Drejtorja e Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2022/23.

Unë vije nga fusha e arsimit dhe ka 32 vite që punoj në arsim dhe mund të kem informata personale mirëpo ajo nuk mjafton sepse duhet të kemi informata zyrtare, dhe gjithëherë e kam thënë se një informatë e arsimit na nevojitet neve, me theks për komunitetin jo shumicë për arsye se në një prej seancave të radhës sigurisht se do të kemi informatë të përgjithshme për fillimin e vitit shkollorë, mirëpo në këtë mbledhje do të duhej të kemi informatë me shkrim për fillimin e vitit shkollor 2022/2023, me theks për komunitetin jo shumicë, gjë të cilën e kam potencuar edhe në mbledhjen e kaluar, në mungesë të kryesuesit të Komitetit. Pra është e thjeshtë të përgatitet një informatë, madje unë për 5 minuta do të përgatitja (fillimi i vitit shkollor, nxënësit, tekstet, materialet) do të thotë nuk ka qenë diçka që nuk ka mund të rregullohet.

E njëjta gjë vlen edhe për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e që ne e kemi diskutuar këtë çështje së bashku me shefin e ZKKK dhe me Kryesuesin e Komitetit, dhe Drejtorja e cekur është dashtë ta sjellë një informatë të tillë lidhur me gjendjen e infrastrukturës në lagjet ku jetojnë komuniteti jo shumicë.

znj.Xhevdie Beqiri, zyrtare në ZKKK, theksoi, sa i përket Drejtorisë së Arsimit nuk po dëshiroj të ndërhyjë sepse nuk më takon ajo fushë, mirëpo sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit edhe njëherë dëshiroj të t'ju informoj se për çështjen e komuniteteve brenda Zyrës së Kryeministrit, ftesa me këto projekte infrastrukturore na është dërguar neve si ZKKK, do të thotë ne jemi përcaktuar dhe i kemi cekë 3 projektet ku kanë nevojë Komunitetet jo shumicë, dhe ajo çka ne kemi kërkuar prej Drejtorisë së cekur është që ajo t'i përgatitë ato projekte të cilat janë, rruga "Sami Rama", pastaj ndërtimi i trotuarit dhe ndërtimi i ujësjellësit në disa lokacione ku jetojnë familje të komunitetit jo shumicë.

Do të thotë se puna e DSHPMSH ka qenë vetëm përgatitja e këtyre projekteve të cilat pastaj do të dërgohen në Zyrën e Kryeministrit, kështu që pa problem unë edhe njëherë mund t'ju njoftoj

rreth këtyre projekteve që i ceka edhe pse nga Drejtoria përkatëse nuk është askush prezent, dhe kjo për faktin që projektet janë në kuadër të Zyrës për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit.

z.Haki Rudari, duke i'u përgjigjur parafolësës theksoi, nuk e di sa jemi të qartë sepse kompetenca e Drejtorisë në fjalë është krejt diçka tjetër për dallim nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, andaj edhe këto projekte dhe kjo informatë që e potencuat do të duhej të sillej në asketin zyrtar. Unë i kam kolegë që 10-15 vite, mirëpo po dua ta shpjegoj se si shkon kjo në aspektin zyrtar.

znj.Xhevdie Beqiri, zyrtare në ZKKK, theksoi, ftesa për këto projekte na është dërguar direkt neve si ZKKK, prandaj edhe pash të arsyeshme t'ju informoj.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësit, mirëpo ta kemi parasysh se po debatohet ende pa u miratuar rendi i ditës e konsideroj se fillimisht duhet të miratohet rendi i ditës e pastaj të hyjmë në diskutime rreth pikave përkatëse të rendit të ditës, përndryshe ne kemi filluar dhe po debatojmë për pika të rendit të ditës pa u miratuar rendi i ditës, andaj e hedh në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

Njëzëri, me 6 vota për nga anëtarët sa janë prezent në mbledhje, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 08 shtator 2022

Njëzëri, me 6 vota për nga anëtarët sa janë prezent në mbledhje, miratohet procesverbali pa vërejtje apo plotësim ndryshime, sipas materialit të dërguar.

2. Informatë nga Drejtoria e Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2022/23, me theks të veçantë për nxënësit e Komuniteteve jo shumicë për përkrahje dhe ndihmë me mjete financiare, dhe tekstet shkollore për nxënës të Shkollave të Mesme të Larta.

Meqë askush nuk shprehi gatishmëri për të marrë fjalën, zyrtari i zyrës përkatëse për punë të Kuvendit sugjeroj që të diskutohet për këtë temë sepse kjo pikë e rendit të ditës është paraparë nga vet ju, dhe atë pa material në formë të shkruar, andaj duhet të diskutohet diçka sepse besoj se informata të ndryshme rreth nxënësve të komuniteteve jo shumicë keni, edhe pse nuk i keni në formë të shkruar. Prandaj meqë është përcaktuar kjo pikë dhe e njëjta u miratua paraprakisht për rend të ditës, është mirë të diskutohet diçka dhe të jepen informata nga kushdo që ka e jo të kalohet vetëm ashtu, sepse me vetëdije e keni sjellë këtë temë pa material, e që ndoshta është dashtë që brenda kësaj periudhe prej thirrjes së mbledhjes deri më sot, të grumbullohen informata të ndryshme qoftë përmes takimeve me komunitetet jo shumicë qoftë përmes Drejtorisë së arsimit.

Pavarësisht kësaj, është e juaja si veproni, por kjo ishte si këshillë nga përvoja e mandateve të kaluara.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nga të gjitha informatat që kam unë si Kryesues, gjithë nxënësit e komunitetit ashkali, rom dhe egjiptas janë regjistruar në shkolla, duke filluar nga parashkollorët e deri në shkolla të mesme, kështu që për momentin nuk kemi asnjë nxënës të pa regjistruar kështu që unë i falënderoj në radhë prindërit e tyre që i kanë regjistruar

fëmijët e tyre, për çka edhe ne kemi bërë një hulumtim në aspektin që asnjë fëmijë / nxënës i komunitetit jo shumicë të mos jetë jashtë procesit mësimor.

Gjithsesi kemi një mangësi të madhe sepse shkolla (Qendra) për mësimnxënie nuk ka filluar punën e që kjo është një ndër pyetjet kryesore për nxënësit ashkali, rom dhe egjiptas, e që është në dëm të nxënësve sepse mësimdhënësit në atë qendër ju kanë ndihmuar shumë në detyra etj.

Sa jam në dijeni, shkaqet janë mos pagesa e mësimdhënësve, ne nuk kemi informata përse ka ndodhë një gjë e tillë dhe ku janë arsyet dhe shkaqet, por ata mësimdhënës kanë punuar 1 vit pa pagesë dhe tani nuk janë duke punuar më, kështu që po vërehet një mungesë tek nxënësit sepse gjatë vijimit në atë qendër mësimore janë ndihmuar në punimin e detyrave shkollore, madje edhe detyrave të shtëpisë pasi që sigurisht jemi në dijeni se shumica e nxënësve të komuniteteve jo shumicë prindërit e tyre nuk i kanë të përgatitur në aspektin e ndihmës mësimore, por që në atë qendër kanë qenë mësuesit të cilët i'u kanë ndihmuar atyre në çështje të ndryshme mësimore, sikurse që janë detyrat e shtëpisë dhe shpjegime të ndryshme aty ku është vlerësuar mungesë e mësimnxënies, prandaj për këtë arsye meqë anëtare në këtë komitet kemi një ish mësuese të asaj qendre, do të doja që t'ia kalojmë fjalën dhe të na jep informata shtesë rreth asaj qendre.

znj. Sevdije Mustafa, theksoi, të nderuar, unë sot flas si një grua që vije nga komuniteti jo shumicë në Kosovë e që mburrem që vije nga ky komunitet ashtu siç mburren edhe nga komunitetet tjera. Kur institucionet lokale na diskriminojnë neve, unë dhe bashkëkombësit e mijë mendojmë se komuniteti ynë është pasuria kombëtare dhe pjesë e rëndësishme e shoqërisë.

Ne nuk duam të kemi privilegje por duam të kemi të drejta të barabarta si dhe të kemi të drejtën elementare për të jetuar, e jetesa na obligon të punojmë ndërsa puna po bëhet e vështirë sepse pushtetet aktuale nuk na e lejojnë një gjë të tillë. Fëmijët e këtij komuniteti që jetojnë në Kosovë, ka ndodhur që festën e abetares ta kalojnë nëpër shkallët e shkollës sepse mësuesit nuk i lejonin që të bashkohen me Shqiptarët në festën e abetares.

Hiç më mirë në këtë aspekt nuk qëndron as Komuna jonë, kjo Komunë e cila ka premtuar punësim për komunitetin jo shumicë, të hap vende të reja pune, por në fakt edhe ato vende që i kishim na i mbyllen.

Para juve dua ta bëjë ditur se Qendra për mësim shtesë që vepron që nga vitit 2013 në dy shkolla të Podujevës, është e mbyllura. Kjo është e vetmja ndërsa për fëmijët tanë shpreheshin talentin e tyre në edukim dhe arsim, pra e vetmja mbështetje për fëmijët e komuniteteve jo shumicë ishte kjo, ndërsa ata që ishin të punësuar aty mbeten të papunë.

Nga viti 2013 Organizata VORAE ka dhënë mbështetje financiare dhe morale.

Partitë politike na premtuan që me ardhjen e tyre në pushtet, kjo qendër mësimore do të bëhet e mbështetshme nga Komuna, kurse pas marrjes së pushtetit së bashku me Organizatën VORAE arritën marrëveshje që Komuna t'i paguaj mësimdhënësit e qendrës, por kjo nuk ndodhi dhe që ne tre mësues që ishim punuam 1 vit dhe nuk u paguam asnjë cent edhe pse nënshkruam dy kontrata në Komunën e Podujevës.

Komuniteti ynë ka nevojë për këto Qendra mësimore, andaj lusë Komunën tonë dhe Kryetarin e Komunës që t'i hap sërish këto Qendra për të cilat është zotuar se do t'i kryej këto punë, kurse ne jemi të gatshëm që të ndihmojmë fëmijët tanë.

z.Haki Rudari, theksoi, e përcjella me vëmendje diskutimin e koleges parafolëse nga radhët e komunitetit jo shumicë, megjithatë i potencoj disa çështje për të cilat unë personalisht nuk pajtohem, ndër të tjera e potencoj se “ne diskriminohem” e që unë nuk pajtohem me këtë fjalorë sepse nuk ka diskriminim në Komunën e Podujevës, përkundrazi është një prej Komunave që ndoshta i ka raportet shumë të mira dhe të shkëlqyeshme me komunitetin jo shumicë, informatë të cilën e kam edhe nga shefi i Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim z.Liman Zeqiri.

Andaj do të ishte mirë që parafolësja kolege ta tërheqë atë, sepse Komuna e Podujevës nuk diskriminon.

Çështja tjetër, e them dhe po e vërtetoj këtë sepse unë jap mësim në shkollën “Shaban Shala” ku ka nxënës të komunitetit jo shumicë që unë ju jap mësim, dhe kurrfarë diskriminimi nuk ka aty, pra përveç çështjeve arsimore ku ka parime, disiplinë dhe kriterium, përkundrazi tek ata nxënës kemi ndoshta edhe më shumë kujdese më të veçantë, prandaj i drejtohem koleges parafolëse se ajo që e potencoj nuk qëndron, nuk e përkrahi atë dhe do të ishte mirë që të tërhiqej ajo sepse Komuna e Podujevës, Kryetari i Komunës dhe Kryetarët paraprak nuk kanë bërë dhe nuk bëjnë diskriminime. Pastaj jam në dijeni se ka edhe shkolla tjera ku mbajnë mësim edhe nxënësit e komunitetit jo shumicë sikurse që është shkolla e fshatit Batllavë por edhe në shkolla tjera, andaj asnjëherë nuk kemi dëgjuar që në Komunën e Podujevës ka diskriminim, e që rreth kësaj çështje këtu prezent e kemi edhe përfaqësuesen nga ZKKK, mirëpo për mua deklarata e parafolëses është e papranueshme.

Gjithashtu nga parafolësja u potencua çështja e festës së abetares nëpër oborre të shkollës, e që konsideroj se kjo deklaratë është paksa e ngutshme dhe këtë e bazoj në një çështje që mendoj se vetëm e vërteton këtë që po e them, dhe atë, Ministria e Arsimit ka hapë një afat, në kuptimin e në risie rreth përkrahjes pikërisht për nxënësit dhe studentët e komunitetit jo shumicë, për përkrahje materiale, pra Ministria e Arsimit ka hapë një afat për t’iu ndihmuar këtyre nxënësve dhe studentëve me bursa, nuk e di a keni këtë informatë por kjo që po e them është zyrtare, prandaj edhe kjo që e ceka e vërteton atë se nuk ka diskriminim. Pajtohem që kushtet mund të jenë më të mira, por megjithatë në të çështjet tjera nuk pajtohem.

Sa i përket qendrës për mësim shtesë për të cilën u tha se është e mbyllur dhe që mesësit kanë punuar pa pagesë për 1 vit, mendoj se është diçka që duhet të debatohet qoftë mes nesh qoftë me Drejtorinë e Arsimit apo edhe me Drejtorinë e Financave, me qëllim që të gjenden mënyra që normal ata që kanë punuar edhe të paguhen.

znj. Sevdije Mustafa, duke i’u drejtuar me pyetje parafolësit, theksoi, si do ta quash ti mbylljen e Qendrave mësimore ndryshe, meqë po e potenconi se nuk është diskriminim.

Të vetmen mënyrë që e kanë pasë komuniteti jo shumicë, unë po besoj se ka qenë kjo Qendër për mësim shtesë. Po thuajse shumica e komunitetit jo shumicë është i pashkolluar, ndërsa tani ku të shkollohen kur nuk i kanë më edhe ato qendra që i patën, prandaj unë nuk mund ta quaj ndryshe këtë çështje përveç asaj që e potencova më parë.

z.Haki Rudari, theksoi, nuk kemi të bëjmë me diskriminim për arsye se nxënësit e komunitetit jo shumicë shkollohen në objekte publike, madje e ceka se këtu afër në shkollën “Shaban Shala” ku punoj unë kemi nxënës të komunitetit jo shumicë, pra shkolla është publike, tekstet ju janë shpërndarë dhe komplet kurrikula si dhe të gjitha tjera janë të njëjta, prandaj edhe njëherë ju them që ta besoni këtë se kurrfarë ndryshimi nuk ka.

Qendra për mësim shtesë, dhe shkollat publike janë të kundërta dhe kanë dallime. Nëse ato Qendra i kanë mbyllë e që unë nuk kam informata në atë drejtim, në shkollat publike ka nxënës të komunitetit jo shumicë për çka ndokush këtu mund të ketë informata edhe më shumë se unë, por sa jamë në dijeni në shkollat “Naim Frashëri”, “Shaban Shala”, “Dr Ibrahim Rugova”, pastaj në shkollën e fshatrave Batllavë, Orllan, andaj ndryshe nuk e di se mund ta quajmë këtë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë për 6 vite kam punuar mediator i arsimit dhe diskriminim tek nxënësit nuk ka pasë dhe që nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas kanë qenë të barabartë me nxënësit Shqiptar, përveç që kanë mundë të kenë pasë privilegje, madje ndoshta diskriminim pozitivë, kështu që deklarata / fjala e shprehur “diskriminim” është bukur e madhe, ndërsa sa i përket mbylljes së Qendrave të mësimi shtesë

unë nuk besoj se kemi të bëjmë me diskriminim por kemi të bëjmë me mos marrëveshje mes Komunës dhe çështjes së mos gjetjes së mënyrës për marrjen e pagave nga ana e mësuesve që kanë punuar aty, andaj për këtë çështje mendoj se duhet të ndërmerret hap konkret sepse e vetmja zgjidhje për nxënësit e komunitetit roma, ashkali dhe egjiptas janë qendrat e mësimimit dhe aftësimit shtesë, qendra me të cilat kemi arritur që shumicën e nxënësve ti ndalim në shkolla dhe t'jua mundësojmë mësimnxënien, dhe kur e them këtë jemi në dijeni se ka pasë një braktisje shumë të madhe nga shkollimi prej nxënësve të komunitetit jo shumicë, e që përmes këtyre qendrave ne kemi arritur që asnjë nxënës i komunitetit jo shumicë të mos e braktisë shkollimin. Pra duke i'u falënderuar mësuesit që kanë punuar në ato qendra, prandaj bëjë apel dhe lus që Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Arsimit, të ndërmarrin masa që ato kontrata të zbatohen dhe të paguhen ata mësues dhe që qendrat e aftësimit shtesë të hapen, përndryshe kam frikën se në të ardhmen do të kemi braktisje të nxënësve të komunitetit jo shumicë nga shkollimi, e që nuk ka ndodhë kohëve të fundit. Pra është mirë të merremi me këtë çështje, konkretisht me hapjen e qendrave të mësimimit shtesë sepse e Komuna e Podujevës është e vetmja është që këto qendra i ka të mbyllura. Si kanë arritur Komunitat tjera që t'i fusin në paga mësuesit nuk jam në dijeni, por në Komunën e Podujevës nuk kanë mund të hyjnë në listën e pagave mësuesit e atyre qendrave që 1 vit, e që konsideroj se të punohet 1 vit pa paga vërtetë është shumë sepse edhe këta kanë familje dhe nevoja të ndryshme.

Prandaj kërkoj që gjithsesi Qendrat e mësimimit shtesë të hapen e që edhe drejtorët e shkollave janë dakord që të hapen ngase nxënësit që kanë vijuar mesmin shtesë në ato Qendra janë edhe nga komuniteti shumicë, jo vetëm nga komuniteti jo shumicë.

znj.Xhevdie Beqiri, zyrtare në-ZKKK, theksoi, për tu ndërlidhur me dy parafolësit, dëshiroj ta potencoj edhe unë që vije nga fshati Sfeqël dhe në atë shkollë ka nxënës të komunitetit jo shumicë, madje edhe në kohën sa kam qenë nxënës në atë shkollë ka pasë nxënës të komunitetit jo shumicë dhe nuk kam parë nga mësimdhënësit, stafi apo të tjerët që ka pasë diskriminim.

Ndërsa sa i përket diskriminimeve që bëhen në shoqëri, mendoj se ato janë të pranishme kudo, janë të pranishme edhe tek ne Shqiptarët si komunitet shumicë e që normal se është një gjë shumë e keqe por që nuk mund të parandalohet tërësisht ashtu siç mendohet.

Sa i përket vijimit të nxënësve në shkolla, unë së bashku me Kryetarin e Komunës, përfaqësuesin e ZKKK, drejtorin e Drejtorisë së Arsimit si dhe me znj.Igballe Imerin përfaqësuese e Organizatës Ndërkombëtare IOM më 21 shtator 2022 kemi vizituar shkollat “Naim Frashëri” në Podujevë dhe “Luigj Gurrakuqi” në fshatin Batllavë, shkolla në të cilat vijnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë e që pikërisht për këto dy arsye IOM ka ndarë / dhënë dy kabinete për këta nxënës. Shkolla “Naim Frashëri” është furnizuar me pajisje muzikore, ndërsa shkolla “Luigj Gurrakuqi” është furnizuar me një laborator me shkencor dhe mjete të konkretizimit.

Pra dua të them se nga këto kabinete përfitues janë edhe nxënësit shumicë por edhe nxënësit e komunitetit jo shumicë

Sa i përket stafit arsimor, duke u bazuar në vizitat nëpër shkolla, nuk ka diskriminim të nxënësve jo shumicë, mësimi mbahet njëjtë dhe nuk ka diskriminim në asnjë aspekt.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, pyet anëtarin e Komitetit dhe mësuesin e Qendrës për arsim shtesë rreth shkaqeve të ndërprerjes së atyre Qendrave, a keni marrë ndonjë vendim apo çfarë është në pyetje, përse është ndërprerë, dhe që a ka pasë diskutime dhe konsultime lidhur me këtë. Dhe në vazhdim thekson, e parashtrova pyetjen sepse unë kam qenë ai që e kam pasë qendrën në fjalë, dhe përderisa unë e kam pasë atë qendër pagat janë bërë me rregull, kurse prej që jam larguar nga Qendrat kanë filluar problemet.

Pra tani unë nuk jam i njoftuar detajisht se çfarë është në pyetje rreth pagave dhe se ku keni ngelë me bisedime mes Drejtorisë së Arsimit dhe juve si mësues/e.

znj. Sevdije Mustafa, duke i'u përgjigjur Kryesuesit, theksoi, ne i kemi nënshkruar 2 kontrata qysh në fillim të vitit shkollor, kurse pagesat nuk na janë bërë duke u arsyetuar se nuk po gjejmë mënyrë ligjore, arsye tjera nuk dimë dhe nuk kemi. Unë nuk e di se si Komunitat tjera e kanë bërë zgjidhjen, por e di se Komuna jonë nuk ka mundur të bëjë zgjidhje.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, do të ishte mirë të gjendet një mënyrë mes juve si mësues/e të Qendrave dhe Drejtorisë së Arsimit, në mënyrë që t'i merrni pagat dhe të filloj mësimi në ato Qendra ngase më së shumti humbin nxënësit, dhe ju që sigurisht pa paga nuk mund të punoni e që keni punuar për 1 vit dhe që mund të them jeni për lëvdatë sepse 1 vit të punohet dhe të mos paguhesh është e tepërte, por për hir të komunitetit jo shumicë keni sakrifikuar dhe keni punuar, prandaj është e rrugës që ta caktojmë një takim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë e Arsimit në mënyrë që të shkojmë edhe modelet e Komunave tjera sa i përket procesit të ardhjes deri tek kontratat dhe pagesat e rregullta, dhe at zgjidhim këtë çështje, e që konsideroj se e pranoni një propozim të tillë.

z.Haki Rudari, theksoi, nga kala e I-rë deri në klasën e IX-të është mësim i obligueshëm, sipas Ligjit përkatës dhe Kushtetutës së Kosovës, dhe në këtë drejtim edhe komuniteti jo shumicë që është i përfaqësuar, sa është i përfaqësuar nuk kam shifra zyrtare por nxënës të këtij komuniteti ka në këtë nivel që e ceka. Pasta ka nxënës të komunitetit j shumicë edhe në shkollë të mesme dhe për këtë jam në dijeni edhe pse numrin nuk e di por që ka.

Sa i përket pagesave të mësuesve të qendrave të arsimit shtesë, u potencua mungesa ligjore, mirëpo unë e cak edhe më herët se është dashtë të debatohet edhe me Drejtorinë e Arsimit, me Drejtorinë e Financave, me Kryetarin e Komunës, dhe të gjenden mënyrat e pagesës dhe aspektit ligjor siç u cek. Por megjithatë edhe njëherë po e potencoj se dallojnë Qendrat e mësimit shtesë me objektet publike sepse nxënësit në objekte publike janë të përfshirë në institucione, janë të përfshirë në mësim, i kanë librat, kurikulat dhe të gjitha i kanë, mirëpo ky aspekti tjetër mund të debatohet me Drejtorinë e Arsimit rreth mënyrës, variantës, pse diku është mundësuar funksionalizimi kurse tek ne jo.

Pra edhe njëherë po e përsërisë se kemi nxënës të komunitetit jo shumicë nëpër objekte publike dhe nuk qëndron ajo që u tha se kemi diskriminim, përkundrazi ndoshta paksa janë të privilegjuar, mirëpo çështja e pagesave të mësuesve të qendrave të mbetet të debatohet nga Kryesuesi i Komitetit bashkërisht me kolegen mësuese të qendrës dhe të kontaktoni Drejtorinë përkatëse.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë kam diskutuar për këtë çështje, më është thënë mjetet materiale janë por metodën se si t'i ekzekutojmë nuk po e gjejmë, dhe për këtë e potencova se është mirë t'i marrim modelet e Komunave tjera se kanë mund ata t'jua ekzekutojnë pagat mësuesve përkatës, kështu që edhe na ta zbatojmë atë ligj. E them këtë për arsye se edhe në Komunitat tjera funksionimi është i njëjtë, klasat i kanë në shkolla, drejtorët e shkollave dhe gjitha tjerat, prandaj konsideroj se kjo është më e mira që mund ta bëjmë.

z.Haki Rudari, theksoi, do të ishte mirë të shkoni në Drejtorinë e Arsimit dhe të merrni informata rreth kësaj çështje.

znj. Sevdije Mustafa, theksoi, kemi qenë në Drejtorinë e Arsimit dhe kemi pyetur rreth kësaj çështje, por asgjë.

Kryesuesi i Komitetit, vazhdoi, Drejtoria e Arsimit ka qenë në dijeni për këtë mbledhje dhe këtë çështje dhe është dashur të vije sot ta shpjegoj dhe ta elaboroj këtë problematikë.

Gjithëherë nga paslufta ka qenë që tekstet shkollore të mësimin të mesëm ju janë shpërndarë nxënësve të komunitetit jo shumicë, por edhe disa nxënësve të komunitetit shumicë që kanë qenë me gjendje të rëndë sociale, kurse tani nuk po e dimë a ka apo jo buxhet apo si qëndron kjo, kështu që mbetet të bisedohet edhe njëherë me Drejtorinë e Arsimit.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Infrastruktura në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, identifikimi dhe paraqitja e projekteve me rëndësi që ndikojnë pozitivisht drejtpërdrejtë për Komunitetet jo shumicë, si dhe shqyrtimi i mundësive për realizimin e tyre përmes buxhetit komunal apo donatorëve eventual.

znj. Xhevdet Beqiri, zyrtarë në ZKKK, theksoi, siç e ceka edhe më herët, sa i përket infrastrukturës në lagjet ku jetojnë komunitetit jo shumicë, Zyra e Komuniteteve brenda Zyrës së Kryeministrit ka dërguar një ftesë e cila ndër të tjera përmban edhe një lloj kërkesë për bashkëpunim me Komunën e Podujevës lidhur me projektet infrastrukturore që janë në të mirën e komunitetit jo shumicë, Zyrë e cila e ke potencuar se nuk ka fonde buxhetor të mjaftueshëm për t'i mbuluar shpenzimet brenda këtij viti, por kanë kërkuar nga ne se çfarë idesh kemi si Komunë për projektet infrastrukturore që janë në të mirë të komuniteteve jo shumicë, e që ndoshta edhe që të gjenden donatorë tjerë për financimin e tyre.

Tri projektet që ne si ZKKK që i kemi dërguar e që siç e potencova edhe më herët se drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit i ka përgatitur dhe i kemi dërguar në Zyrën për Komunitete në kuadër të Zyrës së kryeministrit janë, ndërtimi i trotuarit në fshatin Batllavë rr. "Enver Maloku" e që siç e dimë në fshatin Batllavë jetojnë 12 familje të komunitetit jo shumicë me 57 anëtarë, që ndërtimi i trotuarit në afërsi të shkollës "Luigj Gurraçiqi" do t'i ndihmonte fëmijët, dhe jo vetëm të komunitetit jo shumicë por edhe të komunitetit shumicë në mënyrë që ta kenë një siguri më të madhe në trafik përgjatë rrugës për në shkollë, projekt i cili është paraparë në shumë financiare 18,379.00€. Pastaj projekti tjetër është ndërtimi i rr. "Sami Rama" në lagjen në afërsi të rrugës "Xhafer Meta" ku jetojnë familje të komunitetit jo shumicë, rrugë në të cilën jetojnë 58 familje me një numër prej 315 banorë të komunitetit jo shumicë dhe që kërkesë e tyre ka qenë që të ndërtohet ajo rrugë në mënyrë që ata ta kenë më të lehtë qasjen apo lidhjen me rrugë të tjera të qytetit, projekt i cili është paraparë në shumë 16,162.00€, si dhe projekti tjetër që ne e kemi dërguar në Zyrën e Kryeministrit është projekti për ndërtimin e ujësjellësit në rrugën "Ulqini" në afërsi të rrugës "Ali Ajeti" ku jetojnë 71 familje me gjithsej 496 banorë të komunitetit jo shumicë, e që kërkesë e kahershme e tyre ka qenë ndërtimi i një rrjeti të ri të ujësjellësit sepse ai aktual që është nuk mund t'i furnizoj me ujë të pijes, andaj duke parë rritjen e asaj lagjeje paralelisht janë rritë edhe kërkesat që ta kenë një rrejt të ri të ujësjellësit, projekt i cili parashihet të ketë vlerën 38,939.00€.

Pra për këto tri projekte, vazhërisht mundësive buxhetore të Zyrës për Komunitete në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, apo varësisht donatorëve potencial që mund t'i sigurojnë për financimin e këtyre projekteve, do të zgjedhin njërin prej tyre varësisht fondeve që kanë në dispozicion, e që ende nuk kemi marrë përgjigje dhe realisht janë në shqyrtim të këtyre çështjeve, por që jemi në pritje të konfirmimit të tyre lidhur me financimin e realizimit të projektit apo projekteve.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësen për informatën e dhënë, mirëpo vetëm një çështje do ta them, projektet që janë për komunitetet jo shumicë, është mirë të njoftohet ai komunitet në mënyrë që të jenë në dijeni për projektin përkatës, a është i nevojshëm ai apo eventualisht ka nevojë për ndryshim dhe plotësim të të njëjtit në ndonjë çështje që mund të jetë më urgjente, e sidomos siç është komuniteti jo shumicë që jeton në rr. “Ali Ajeti” që kanë nevojë për ujë të pijes ngase vazhdimisht i’u bie të dalin të furnizohen me ujë të pijes sepse uji që kanë është pa pijshëm për arsye se gypet aktuale janë vjetërsuar dhe ka rrezik për ndonjë sëmundje, prandaj e përsëris se është mirë që çdo projekt që prek komunitetin jo shumicë të informohet ai komuniteti.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë edhe këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj të përfunduar, dhe kalojmë në pikën e radhës.

znj.Xhevrie Beqiri, zyrtare në ZKKK, lidhur me kërkesën e Kryesuesit të Komitetit, theksoi, natyrisht se këtë kërkesë tuajën për tu informuar komunitetit jo shumicë lidhur me projektet në ato lagje ku jetojnë ata, do ta kemi parasysh në të ardhmen.

4. Të ndryshme

z.Arbnor Fazliu, propozoj që vizitat e parapara nëpër shkolla të realizohen, qoftë edhe sot nëse është e mundshme, apo të caktohet një ditë tjetër.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, kur do që dëshironi dhe që si anëtar të Komitetit jeni të lirë mund të vizitohet shkollat ku ka nxënës të komunitetit jo shumicë. Konsideroj se shkollat që janë në Qytet mund t’i vizitohet qysh sot.

z.Haki Rudari, theksoi, mendoj se është mirë at vizitohet Shkollën e fshatit Batllavë meqë edhe paska një projekt i cili pritet të realizohet atje por edhe që siç u informuam ajo shkollë qenka pajisur me një kabinet, pastaj janë edhe një numër i familjeve të komuniteti jo shumicë që jetojnë në atë fshat.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë sa isha anëtar i Komitetit për Komunitete por edhe duke u bazuar në OJQ-në që e udhëheqë unë, ne kemi bërë një projekt për nxënësit e shkollës “DR Ibrahim Rugova” qoftë për ata të komunitetit jo shumicë qoftë për ata shumicë, pra e kemi dërguar një projekt shumë të madh që ka qenë një kabinet me laborator.

z.Arbnor Fazliu, theksoi, nëse jeni të pajtimit, shkollat e Qytetit do t’i vizitonim qysh sot pas mbledhjes, ndërsa për shkollat tjera në fshatar siç ishte ajo e Batllavës do ta caktonim një datë tjetër kurdo që e shohim të arsyeshëm.

z.Haki Rudari, theksoi, do të ishte mirë që paraprakisht të njoftohen drejtorie e shkollave përkatëse në mënyrë që të jenë të përgatitur rreth vizitave. Kryesuesi i Komitetit mund t’i siguroj numrat e telefonit të tyre dhe t’i njoftoj paraprakisht ata.

Sa i përket çështjes se kur jemi të lirë apo të zënë ne si anëtar të Komitetit, besoj se ky Komitet është trupë e Kuvendit të Komunës, dhe anëtarët e Kuvendit janë të liruar nga puna kur kanë punë në këtë organ, prandaj nuk është problemi se kush është i lirë apo kush është i zënë, ne vetëm mund ta caktojmë datën, kohën dhe vendin, ndërsa vizitës i bashkëngjitet kush do që dëshiron dhe që mundet, mirëpo është mirë të njoftohen ato shkolla sepse natyrisht ka mësim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë unë të hënën po i njoftoj drejtorët e atyre shkollave dhe njëkohësisht po i caktoj vizitat, kur do që jeni të lirë mund të bëjmë vizitat nëpër shkolla.

Pas diskutimeve, si përfundim mbetet që Kryesuesi i Komitetit fillimisht t'i kontaktoj drejtorët e shkollave përkatëse dhe të caktoj ditën dhe kohën e vizitave nëpër shkollat përkatëse, pastaj përmes e-mailit apo kontakteve telefonike do të njoftohen anëtarët e Komitetit dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë Komitet, si dhe do të sigurohen edhe çështje tjera teknike, siç është transporti.

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i mbledhjes e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.prot.01-060/04-0088325/22

Podujevë, 14 tetor 2022

Kryesues i Komitetit

Xhafer Ademi